

2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr.17083/11529/6918(31155-05652-86-2017)Regjistri
Datë 15.11.2017 Regjistrimi

Nr.3153Vendimi
Datë 12.12.2019

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Administrative e Apelit e përbërë nga gjyqtarët:

Kryesues: Arjan Qafa
Anëtare: Altina Nasufi
Anëtare: Fjoralba Prifti

Asistuar nga sekretare gjyqësore [REDACTED], në Tiranë në datë 12.12.2019 mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen administrative me nr.17083/11529/6918(31155-05652-86-2017)Regjistri, datë 15.11.2017 regjistrimi, me palë ndërgjyqëse:

Paditës: Ujësjiellës Kanalizme Tiranë sh.a, me adresë Rruga "5 Maji", Tiranë.
I paditur: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me adresë Rruga "Sami Frasheri", nr.10, kati 2.

Personi i tretë: [REDACTED]

Objekti: Kundërshtimi dhe shfuqizimin e Vendimit nr.197, datë 29.12.2016 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nr.1181/1 prot, datë 29.12.2016 protokolluar me tonen Nr. K-10, datë 04.01.2017.

Baza Ligjore: Nenet 31, 154, 324, 327, 328, 331, 676 të Kodit të Procedures Civile, Nenet 4, 13, 47, 56, 113, 115, 117 të Kodit të Procedures Administrative, Nenet 12, 21, 24, 141, 143, 144, 145, 148, 153, 154 të Kodit të Punës. Ligji nr.10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi."

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.3706, datë 03.10.2017, ka vendosur:

- Rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova.

- Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

- Kunder këtij vendimi lejohet ankimi brenda 15 ditëve nga e nesërmeja e shpalljes në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë, afat që për palët në mungesë nis nga dita e marrjes dijeni.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim pala paditëse Ujësjiellës Kanalizme Tiranë sh.a, e cila, në ankimin e saj ka kërkuar, ndryshimin e vendimit nr.3706, datë 03.10.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pranimin e kërkesë padisë, për shkaqet si vijon:

Vendimi nr.3706, datë 03.10.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është marrë në shkelje të ligjit material dhe procedural për shkaqet që do të parashtrojmë në vijim.

Komisioneri për Mbrojtjen kundër Diskriminimit, me vendimin nr.197 datë 29.12.2016 të Komisionerit për Mbrojtjen kundër Diskriminimit, nr.1181/1 prot, datë 29.12.2016, protokolluar

me tonën Nr.K-10, datë 04.01.2017 ka vendosur konstatimin e diskriminimit të drejtëpërdrejtë, për shkak të bindjeve politike, të z. [REDAKTUAR] nga ana e drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë UKT sh.a. z. [REDAKTUAR] ka qënë në marrëdhënie punë me Shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a nga data 14.02.2014 me detyrë “Shofer” në Drejtorinë e Transportit dhe Oficinës.

Me vendimin nr.222 datë 14.02.20165 palës paditëse ju komunikua emërimi në punë me detyrë “Shofer” ne Drejtorinë e Transportit dhe Oficinës. Me Vendimin nr.1164 datë 30.12.2015 palës paditëse ju komunikua zgjidhja e marrëdhënies së punës për shkaqe të justifikuara për shkak të shkurtimit të vendit të punë.

Referuar neneve 4, 13, 47, 56, 113, 115 dhe 117 të Kodit të Procedures Administrative, dhe neneve 12, 21, 141, 143, 144, 145, 148, 153, 154 të Kodit të Punës fakteve dhe rrethanave të lartë përmendura arsyetojmë se:

Vendimi nr.197, datë 29.12.2016 i Komisionerit për Mbrojtjen kundër Diskriminimit është akt administrative. Gjykata ka gabuar kur në përfundim të shqyrtimit gjyqësorë e ka cilësuar këtë akt si një akt të nxjerrë në përputhje me dispozitat ligjore. Ky akt është nxjerrë në kundërshtim dhe në zbatim të gabuar me ligjin material. Komisioneri e nxjerr këtë vendim në kuptim të gabuar të ligjit material, të vendimeve unifikuese dhe të praktikës që ndiqet nga gjykata përsa i përket interpretimit dhe kuptimit të nenit 21, 24 dhe 148 të Kodit të Punës si dhe nenit 676 të Kodit të Procedures Civile. Me vendimin nr.1164, Prot datë 27.10.2015 z.Hoti ju komunikua ndryshimi i pozicionit ku kaloi si drejtues i mjeteve teknologjike.

Në gjykimin tonë vendimi për transferimin e palës nga një pozicion punë në një tjetër është një e drejtë që i garantohet shoqërisë nga nevoja e organizimit të brendshëm të punës. Në rastin konkret ndryshimi është bërë për shkak se të nevojës së brendshme organizative. Si pasojë z. [REDAKTUAR] është transferuar në një detyrë tjetër e cila është në të njëjtën strukturë organizative në të cilën pala ka ushtruar detyrën e meparshme. Është e vërtetë që kanë ndodh ndryshime përsa i përket pages dhe pozicionit të punës së punëmarrësit por kjo në asnjë rast nuk mund të cilësohet e paligjishme.

Zgjidhja e marrëdhënies së punës me z.Hoti është bërë në zbatim të Nenit 148 të Kodit të Punës. Nga provat vërtetohet se pala e paditur Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a, ka respektuar kërkesat ligjore dhe proceduriale për pushimin kolektiv nga puna, të parashikuara në nenin 148 të Kodit të Punës.

Kështu me shkresat nr.24772 Prot, Datë 11.12.2015 , nr.518/2 prot, dt 08.02.2010 dhe shkresën nr.24772/1 i është bërë njoftimi, Sindikatës dhe Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, për pushim nga puna të punonjësve të UKT sha për shkak të ndryshimeve në strukturën organizative dhe në zbatim përcaktimeve te Nenit 148 bëhet njoftimi për të filluara këshillimet brenda afatit 20 ditor nga data e njoftimit.

Arsyet e pushimit kolektiv nga puna, janë bërë për nevoja të riorganizimit dhe jo për arsye që kanë të bëjnë me punëmarrësin. Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a. ka pasur te punësuar rreth 1300 punonjës. Me vendimin nr.25 datë 09.12.2015 te Asamblese së Përgjithshme të Aksionerëve është vendosur që struktura e re do të përbëhet nga 864 punonjës. Sipas përcaktimeve te Nenit 148 paragrafi 1 të kodit të punës në të cilin përcaktohet se: “Vlerësohet pushim kolektiv nga puna përfundimi i marrëdhënieve të punës nga punëdhënësi për arsye që

nuk kanë të bëjnë me punëmarrësin, kur numri i pushimeve nga puna, brenda 90 ditëve, është të paktën 30 për ndërmarrjet me mbi 300 punonjës”

Ndodhja apo jo përpara pushimit kolektiv ligjvënësi e lidh drejtpërdrejtë me numrin e personave të pushuar nga puna dhe jo me faktin nëse UKT-ja respekton apo jo procedurën e pushimit kolektiv, pasi në thelb dhënia e përparësisë së rimarrjes në punë të punëmarrësve të pushuar nga puna është një parashikim i bërë në neni 148 pika 7. Dhe në këtë rast komisioneri ka një kuptim të gabuar të ligjit e të ndryshëm nga qëllimi i ligjvënësit.

Lidhur me trajtimin e diferencuar, konkluzionet e Komisionerit për Mbrojtjen kundër Diskriminimit nuk janë nxjerrë në mënyrë objektive.

Sipas nenit 3 të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 me diskriminim do të kuptojmë çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi. Nga interpretimi i këtij neni do të kuptojmë se personi do të konsiderohet i diskriminuar kur ai ose një grup i caktuar personash është trajtuar në një mënyrë të diferencuar në raport me një tjetër apo një grup të caktuar personash, në një situatë të njëjtë ose të ngjashme apo për një nga arsytet e parashikuara në nenin 1 të ligjit të sipërcituar.

Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime sh.a respekton të drejtat e punëmarrësve si dhe të drejtat e tyre personale të cilat janë të parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë si dhe në ligjet në fuqi. Në asnjë rast nuk ka trajtuar punonjësit në mënyrë diskriminuese dukë përfshirë këtu dhe z. [REDAKTUAR]. Siç është shpjeguar dhe më sipër, z. [REDAKTUAR] nuk ka qënë punonjësi i vetëm i cili është prekur nga ristrukturimi i shoqërisë, por së bashku me të janë prekur dhe pozicionet e punës për 436 punonjës të tjerë. Në thelb ristrukturimi i shoqërisë nuk merret me punëmarrësin si individ por me pozicionin e punës të përcaktuar në Rregulloren e Brendshme të Shoqërisë.

z. [REDAKTUAR] mund të pretendonte se ishte trajtuar në mënyrë diskriminuese vetëm në rastin kur procedura e ndërprerjes së marrdhënies së punës për të do ishte e ndryshme nga procedura e ndjekur për punonjësit e tjerë, çka do të çonte përpara njëres prej formave të parashikuara në ligjin “Për mbrojtjen kundër diskriminimit”. Duke qënë se kjo procedurë është e njëjtë për të gjithë punonjësit të cilëve u është ndërprerë marrdhënia e punës me UKT Sh.a, dhe për më tepër konform procedurës së parashikuar në Kodin e Punës, kurrsesi nuk mund të ndodhemi përpara diskriminimit të drejtpërdrejtë apo përpara ndonjë prej llojeve të tjera të diskriminimit të parashikuar në ligj, dhe aq më pak përpara diskriminimit për shkak të bindjeve politike. Nga ana tjetër UKT-ja nuk ka patur dijeni për bindjet politike të Z. [REDAKTUAR] pasi një dokumenti tillë nuk cilësohet në dosjen personale të punonjësve.

Si konkluzion ky akt është në kushtet e paligjshmërisë referuar nenit 109/d ku përcaktohet shprehimisht.

Neni 109

Paligjshmëria e akteve administrative

Një akt administrative është i paligjshëm nëse:

c) është në kundërshtim me ligjin material

Dua ti bëjë me dije Gjykatës se, Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Tiranë ka depozituar 6 kërkesë-padi për shfuqizimin e vendimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pranë Gjykatës Administrative Tiranë. Konkretisht:

1-Kundërshtimi dhe shfuqizimi i vendimit nr.201, datë 29.12.2016 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

2-Kundërshtimi dhe shfuqizimi i vendimit nr.165, datë 14.11.2016 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

3-Kundërshtimi dhe shfuqizimi i vendimit nr.324, datë 27.12.2016 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

4-Kundërshtimi dhe shfuqizimi i vendimit nr.214, datë 30.12.2016 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

5-Kundërshtimi dhe shfuqizimi i vendimit nr.202, datë 29.12.2016 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

6-Kundërshtimi dhe shfuqizimi i vendimit nr.197, datë 29.12.2016 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka dal me vendim duke u mbështetur në dokumentacionin e pushimit kolektiv që i është vendosur në dispozicion nga Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Tiranë. Shkaku për të cilat pretendohet diskriminimi në të gjitha çështjet e sipërpërmendura është i njëjtë, ajo që ndryshon janë subjektet të cilët kanë vendosur në lëvizje Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në të gjitha rastet e sipërcituara, gjykata ka pranuar kërkesë padinë e depozituar nga ana jonë përveç rastit objekt akimin.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

në dhomë këshillimi, pasi dëgjoi relatimin e çështjes nga gjyqtari Arjan Qafa, shqyrtoi të gjitha aktet shkresore dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Se pranë Gjykatës Administrative të Apelit ka ardhur për gjykim çështja administrative me palë dhe objekt të sipërcituar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë në bazë të ankimit të bërë nga pala paditëse Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a.

Nga shqyrtimi i çështjes në dhomë këshillimi mbi bazën e dokumenteve, Kolegji i Gjykatës Administrative të Apelit çmon se vendimi nr.3706, datë 03.10.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është i drejtë dhe si i tillë, duhet të lihet në fuqi. Vendimi objekt ankimi është rrjedhojë e analizës së drejtë të provave dhe zbatimit korrekt të ligjit, për rrjedhojë shkaqet e ngritura në ankim nga pala paditëse për pranimin e ankimit, nuk qëndrojnë.

Kolegji, ndryshe nga sa pretendon pala paditëse, konkludon se gjykata në vendimin e saj objekt shqyrtimi në apel administrativ, i ka dhënë përgjigje gjithë kërtimeve dhe prapësimeve të palëve në proces.

I.Rrethanat e Çështjes:

Nga aktet e administruara në dosje ka rezultuar se, personi i tretë në këtë gjykim, [REDAKTUAR] ka filluar punë pranë palës paditëse, me datë 17.02.2014. Marrëdhëniet e punës ndërmjet palëve, kanë vazhduar deri me datë 31.12.2015, datë në të cilën pala paditëse, nëpërmjet vendimit numër 1164, datë 30.12.2015, ka vendosur zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, me motivacionin "Për shkak të suprimimit të vendit të punës", sipas vendimit nr.25, datë 09.12.2015, të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a. Pala e paditur, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), mbështetur në nenin 32, germa a) dhe nenin 33 të ligjit nr.10221, 04.02.2010, "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", rezulton se ka marrë në shqyrtim ankesën nr.02, datë 08.01.2016, të personit të tretë, [REDAKTUAR] kundër [REDAKTUAR], në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të UKT, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të "Bindjeve politike". Ankuesi [REDAKTUAR] ka pretenduar pranë palës së paditur, se ka punuar dy vjet pranë UKT-së, me detyrë shoferi i mjeteve teknologjike, në Sektorin e Transportit dhe Ofiçines. Me emërimin në detyrë si Drejtor i Përgjithshëm i UKT-s, të z. [REDAKTUAR], ankuesi ka pretenduar se për të ka nisur trajtimin në mënyrë të diferencuar, duke mos e angazhuar në punë. Me Vendimin nr.1164, datë 30.12.2015, ankuesi është larguar nga pozicioni i punës, pasi për shkak të ndryshimeve në Strukturën Organizative të Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime sh.a., pozicioni i punës që ai mbante në Sektorin e Transportit dhe Ofiçines është shkurtuar. Ankuesi [REDAKTUAR] ka pretenduar pranë palës së paditur, se fakti që ai ka qene i anetaresuar në Partinë Demokratike të Shqipërisë, ka bërë që Drejtoria e Përgjithshme e UKT-së, të marrë vendimin për largimin e tij nga pozicioni i punës që mbante. Rezultoi se, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr.10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" (KMD), ka shqyrtuar çështjen, duke ndërmarrë hapat si më poshtë, në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32, pika 2 dhe 33, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi". Me anë të shkresës nr.25/1 Prot., datë 18.01.2016, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar informacion nga ana e UKT-së, lidhur me ankesën bërë nga [REDAKTUAR]. Duke qene se në përgjigje të shkresës së sipërcituar, pala paditëse UKT, nuk vendosi në dispozicion të asnjë informacioni, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të shkresës nr. 5/2 prot., datë 23.02.2016, ka kërkuar serish informacion UKT-së lidhur me ankesën e [REDAKTUAR]. Me shkresën nr.5500 prot., datë 09.03.2016, Drejtoria e Përgjithshme e UKT-së, rezulton se ka informuar Komisionerin lidhur me pretendimet e ngritura nga ankuesi, [REDAKTUAR]. Mbështetur në Urdhërin nr.54, datë 30.03.2016, rezulton se inspektorët e KMD-së, kanë inspektuar UKT-në, me datë 04.04.2016, për të administruar informacionin e kërkuar, për shqyrtimin e metejshëm të ankesës së [REDAKTUAR]. Gjatë inspektimit, rezulton se në dispozicion të KMD-së, nuk është vendosur asnjë informacion apo prove, lidhur me kërkesat e urdhërit të inspektimit. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr.10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e metejshëm të çështjes, rezulton se Komisioneri vendosi të realizojë një seancë degjimore mes palëve. Me shkresën nr.25/4 prot., datë 07.04.2016, është bërë njoftimi i palëve për realizimin e seancës degjimore. Me datë 11.04.2016, sipas njoftimeve të realizuara, në seancë degjimore, është paraqitur vetëm përfaqësuesi ligjor i ankuesit, [REDAKTUAR]. Pavarësisht mungesës së palës ndaj se ciles u paraqit ankesa, seanca degjimore, rezulton se është zhvilluar vetëm në

pranine e palës ankuese. Me datë 12.04.2016, UKT, me anë të shkresës nr.7132/1 prot., datë 11.04.2016 në përgjigje të kërkesave të Urdhërit nr.54, datë 30.03.2016 te Komisionerit, rezulton se ka vendosur ne dispozicion aktet siç janë cituar ne vendimin objekt gjykimi. Duke qenë se përgjigja e UKT-së, nuk ka qenë e plotë, bazuar në kërkesat e shkresave te nisura nga KMD, mbështetur ne Urdhërin nr.115, datë 07.07.2016 inspektoret e KMD-së, janë paraqitur serish pranë zyrave te UKT- së, me datë 08.07.2016, për te administruar informacionin e kërkuar, për shqyrtimin e metejshem te ankesës së ankuesit [REDAKTUAR]. Sipas informacionit te administruar gjatë procesit te hetim-inspektimit dhe provave bashkëngjitur shkresës nr.16678/1 prot., datë 17.08.2016 te UKT-së, rezulton se është evidentuar se nga pala e paditur, se për periudhen Tetor 2015-Janar 2016, ne pozicionin Drejtues te Mjeteve, në Drejtorinë e Transportit dhe Oficinës, nga pala paditëse, ishin emëruar 7 (shtatë) punonjës të rinj. Ne përfundim, nisur nga shqyrtimi i këtyre fakteve, Komisioneri ka gjykuar se, "Paligjshmeria e veprimeve te ndermarra nga ana e Strukturave të UKT- së, në dëm te ankuesit, kanë sjellë për pasoje edhe vendosjen e tij në kushte te disfavorshme, duke e larguar nga puna pa shkaqe të arsyeshme dhe duke e trajtuar në mënyrë të diferencuar nga pjesa tjetër e punonjësve." Rezulton se, Komisioneri, ka krijuar bindjen se veprimet e ndermarra nga ana e strukturave te UKT-së, për largimin nga puna te ankuesit Artur Hoti, janë bërë ne mënyrë te qellimshme dhe tendencioze, me synimin përfundimtar të largimit te ankuesit nga puna dhe zëvendësimin e tij me punonjës të tjerë.

Në përfundim te shqyrtimit te realizuar, me vendimin nr.197, datë 29.12.2016 pala e paditur, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka vendosur: *"1.Konstatimin e diskriminimit, për shkak te bindjeve politike, te z. [REDAKTUAR], nga ana e Drejtorit te Përgjithshem te Shoqërisë UKT sh.a. 2.Referuar pikës 1 te këtij Vendimi, te merren masa te menjëherëshme nga ana e Drejtorit te Përgjithshem te Shoqërisë UKT sh.a, për rikthimin ne punë te z. [REDAKTUAR] 3.Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Drejtori i Përgjithshem i Shoqërisë UKT sh.a, te njoftoje Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi. 4.Ne referim te nenit 33, pika 11, te ligjit nr.10221, datë 04. 02. 2011, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasoje ndeshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, te po këtij neni. 5.Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda afateve ligjore.*

II.Vendimi dhe arsyetimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë:

Në analizë të pretendimeve të parashtruara në kërkesë padi, të provave e akteve shkresore të administruara dhe rrethanave të faktit e të ligjit, Gjykata ka vlerësuar se, padia e paraqitur prej palës paditëse është e pabazuar në ligj dhe në prova, ndaj ka disponuar me rrëzimin e padisë, duke arsyetuar se:

Vlerësimi i gjykatës.

Rezultoi e provuar ne këtë gjykim se, pala paditëse, kërkon nga Gjykata shfuqizimin e Vendimit nr.197, datë 29.12.2016 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Rezultoi se, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ne zbatim te parashikimeve ligjore, te përcaktuara ne nenet 32 dhe 33, te ligjit nr.10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" (KMD), ka shqyrtuar çështjen. duke ndermarrë hapat si me poshte, ne zbatim te parashikimeve

ligjore, te përcaktuara ne nenet 32, pika 2 dhe 33, te ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi".

Me ane te shkresës me nr.25/1 Prot., datë 18.01.2016, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar informacion nga ana e UKT-së, lidhur me ankesen bërë nga [REDACTED]. Duke qene se në përgjigje të shkresës se sipërcituar, pala paditëse UKT, nuk vendosi ne dispozicion asnjë infonacion, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me ane te shkresës nr. 5/2 prot., datë 23.02.2016, ka kërkuar serish informacion UKT-së lidhur me ankesen e Artur Hotit.

Me shkresën nr 5500 prot., datë 09.03.2016, Drejtoria e Përgjithshme e UKT- se, rezulton se ka informuar Komisionerin lidhur me pretendimet e ngritura nga ankuesi, [REDACTED].

Mbështetur ne Urdhërin nr.54, datë 30.03.2016, rezulton se inspektorët e KMD-së, kanë inspektuar UKT-në, me datë 04.04.2016, për te administruar informacionin e kërkuar, për shqyrtimin e metejsheem te ankeses se [REDACTED]. Gjatë inspektimit, rezulton se ne dispozicion te KMD-së, nuk është vendosur asnjë informacion apo prove, lidhur me kërkesat e urdhërit te inspektimit.

Mbështetur ne nenin 33, pika 8, te ligjit nr.10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e metejsheem te çështjes, rezulton se Komisioneri vendosi te realizoje një seancë degjimore mes palëve. Me shkresën nr. 25/4 prot., datë 07.04.2016, është bërë njoftimi i palëve për realizimin e seances degjimore. Me datë 11.04.2016, sipas njoftimeve te realizuara, ne seancë degjimore, është paraqitur vetem përfaqësuesi ligjor i ankuesit, [REDACTED]. Pavarësisht mungesës se palës ndaj se ciles u paraqit ankesa, seanca degjimore, rezulton se është zhvilluar vetem ne praninë e palës ankuese.

Me datë 12.04.2016, UKT, me ane te shkresës nr.7132/1 prot., datë 11.04.2016 ne përgjigje te kërkesave te Urdhërit nr.54, datë 30.03.2016 te Komisionerit, rezullton se ka vendosur ne dispozicion aktet siç janë cituar ne vendimin objekt gjykimi.

Duke qene se përgjigja e UKT-së, nuk ka qenë e plotë, bazuar ne kërkesat e shkresave te nisura nga KMD, mbështetur ne Urdhërin nr.115, datë 07.07.2016 inspektorët e KMD-së, janë paraqitur serish pranë zyrave te UKT- se, me datë 08.07.2016, për te administruar informacionin e kërkuar, për shqyrtimin e metejsheem te ankeses se ankuesit [REDACTED].

Sipas informacionit te administruar gjatë procesit te hetim-inspektimit dhe provave bashkëngjitur shkresës nr.16678/1 prot., datë 17.08.2016 te UKT-së, rezulton se është evidentuar se nga pala e paditur, se për periudhen Tetor 2015-Janar 2016, ne pozicionin Drejtues te Mjeteve, ne Drejtorine e Transportit dhe Ofiçines, nga pala paditëse, ishin emeruar 7 (shtate) punonjës te rinj. Ne përfundim, nisur nga shqyrtimi i ketyre fakteve, Komisioneri ka gjykuar se: *"Paligjshmeria e veprimeve te ndermarra nga ana e Strukturave te UKT- se, ne dem te ankuesit, kanë sjelle për pasoje edhe vendosjen e tij ne kushte te disfavorshme, duke e larguar nga puna pa shkaqe te arsyeshme dhe duke e trajtuar ne mënyrë te difereneuar nga pjesa tjeter e punonjësve."*

Rezulton se, Komisioneri, ka krijuar bindjen se veprimet e ndermarra nga ana e strukturave te UKT-së, për largimin nga puna te ankuesit [REDACTED] janë bërë ne mënyrë te qellimshme dhe tendencioze, me synimin përfundimtar te largimit te ankuesit nga puna dhe zëvendësimin e tij me punonjës te tjerë.

Ne përfundim të shqyrtimit të realizuar, me vendimin nr.197, datë 29.12.2016 pala e paditur, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka vendosur: “1. Konstatimin e diskriminimit, për shkak të bindjeve politike, të z. [REDAKTUAR] nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë UKT sh.a. 2.Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëherëshme nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë UKT sh.a, për rikthimin në punë të z. [REDAKTUAR] 3.Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim. Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë UKT sh.a, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi. 4.Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2011, ‘Për mbrojtjen nga diskriminimi’, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasoje ndeshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni. 5.Kunder këtij vendimi lejohet ankimi në gjykatë, brenda afateve ligjore”.

Rezulton pavarësisht se në objekt të kërimit të saj padia ka kundërshtimin në rrugë gjyqësore të aktit administrativ vendimit nr.197, datë 29.12.2016 të marrë nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi për të kundërshtuar vlefshmërinë ligjore të të cilit nuk ka paraqitur asnjë prove apo dispozite konkrete që të jetë shkelur nga ana e organit që ka shqyrtuar kundërvajtjen administrative të konstatuar prej palës së paditur.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është një institucion juridik publik, që funksionon në bazë të ligjit nr.10221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Mbështetur në nenin 21 dhe 32, pika a) e këtij ligji, parashikohet se: “Komisioneri siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin”.

Nga ana tjetër, Komisioneri ka kompetencë:

a) të shqyrtojë ankesat për personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj;

b) të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pelqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi;

c) të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji;

ç) të vendosë sanksione administrative sipas përcaktimit të këtij ligji”.

Rezulton e provuar se sanksioni përkates administrativ kundrejt palës paditëse është vendosur pas moszbatimit nga ana e palës paditëse të Vendimit nr. 54, datë 28.04.2015 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Bazuar në nenin 33 të ligjit nr.10221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, kushdo që pretendon diskriminim mund të paraqesë ankese para Komisionerit.

Në përfundim të gjykimit, gjykata vlereson se Vendimi nr.197, datë 29.12.2016 nuk ka asnjë element që cenon ligjshmerinë duke shkaktuar pavlefshmërinë e tij, qofte pavlefshmërinë absolute qofte atë relative dhe për rrjedhojë, vendimi është i drejtë dhe i bazuar në ligj e në prova.

Në referim të parashikimeve të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, (Kodi i cili ka qenë në fuqi në momentin e fillimit të procedimit administrativ, pra paraqitjes së ankesës (ankesa është regjistruar me nr.2, datë 08.01.2016), rastet e

pavlefshmerise absolute te aktit administrativ parashikohen nga neni 116 te tij, ku sanksionohet se:

“Aktet administrative do te quhen absolutisht te pavlefshme, ne kuptimin e ketij Kodi, ne rastet e meposhtme:

a.kur akti eshte nxjerre nga nje organ administrativ i pidentifikuar;

b.kur akti eshte nxjerre nga nje organ administrativ ne kapercim te kompetencave te tij ligjore;

c.kur akti eshte nxjerre ne kundershtrim me formen dhe proceduren e kerkuar nga ligji. ”

Ne referim te parashikimeve te nenit 116 te K.Pr.Administrative, gjykata vlereson se nuk ndodhemi ne kushtet e gernes “a” te nenit 116 te K.Pr.Administrative, pasi Komisioneri per Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk eshte nje organ i pidentifikuar.

Komisioneri eshte nje institucion i cili eshte krijuar dhe funksionon ne baze te parashikimeve te ligjit nr.10221 date 04.02.2010 “Per mbrojtjen nga diskriminimi”

Per rrjedhoje nuk ndodhemi ne kushtet e gernes “b” te nenit 116 te K.Pr.Administrative, pasi akti eshte nxjerre plotesisht ne perputhje me kompetencat qe ligji nr.10221 date 04.02.2010 i ka dhene Komisionerit. Ne baze te nenit 32, germa “a”, te ketij ligji. parashikohet se, Komisioneri ka kompetence te shqyrtoje ankesat nga personat ose grupet e personave qe pretendojne se jane diskriminuar.

Po keshtu nuk ndodhemi ne kushtet e gernes “c”, te nenit 116 te K.Pr.Adm, pasi akti eshte nxjerre ne perputhje me proceduren e parashikuar nga neni 33 i ligjit “Per mbrojtjen nga diskriminimi”.

Ne referim te parashikimeve te ligjit nr.8485, date 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, pavlefshmeria relative parashikohet nga neni 118 i Kodit.

Ne analize te pretendimeve mbi themelin e vendimarrjes se palës se paditur, gjykata çmon se Vendimi nr.197, date 29.12.2016 i KMD, nuk ka asnjë element qe cenon ligjshmërinë duke shkaktuar pavlefshmërinë relative, pasi eshte marrë ne perputhje te plotë me parashikimet e LMD, ashtu siç edhe eshte pasqyruar me sipër.

Per rrjedhoje gjykata ne përfundim te gjykimit vlerëson se Vendimi i KMD, nuk eshte ne kundërshtim me përmbajtjen dhe qëllimin e ligjit (LMD-se) dhe nuk eshte nxjerre nen ndikimin e lajthimit, mashtrimit, kanosjes apo dhunës fizike, elemente këto qe do te shkaktonin pavlefshëmriinë relative të ketij vendimi.

Per te gjitha sa u thanë me lart, rezulton e provuar në rrugë gjyqësore se Vendimi 197, date 19.12.2016 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi eshte një akt administrativ i drejtë, i bazuar në ligj dhe i nxjerre në respektim të kërkesave ligjore.

Nga ana tjetër, u provua ne gjykim se pretendimet e ngritura nga pala paditëse janë terësisht të pabazuar në prova dhe në ligj.

Gjatë gjykimit pala e paditur përmes provave te paraqitura provoi në rrugë gjyqësore shkeljen administrative te kryer prej paditësit.

Ne gjykim u provuan prapësimet e palës së paditurse ky denim administrativ dhe gjoba konkrete e vendosur nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, rezulton te jenë të bazuar në ligj e në prova.

Nga ana e palës së paditur, sipas parashikimeve të ligjit, është vepruar drejt në konstatimin e kundërvajtjes administrative dhe gjobitjen e subjektit kundërvajtes.

Nisur nga sa më sipër, duke qenë se në rrugë gjyqësore u provua bazueshmëria ligjore e faktike e kryerjes së kundërvajtjes administrative të konstatuar dhe se organi administrativ që ka shqyrtuar ankimin në rrugë administrative rezulton të këtë kryer një hetim të plotë e të gjithanshem, në kushtet kur u provua kjo sipas të gjitha provave shkresore të administruara në gjykim, gjykata vlerëson se duhet të rrëzojë padinë si të pabazuar në ligj e në prova.

III. Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit:

Në analizë të ankimit të paraqitur nga pala paditëse Ujësjetllës Kanalizme Tiranë sh.a, ndaj vendimit objekt ankimi dhe në analizë të akteve të dosjes si dhe në referim të përcaktimeve të ligjit material dhe procedural që gjen zbatim në rastin konkret, Gjykata Administrative e Apelit çmon se: vendimi nr.3706, datë 03.10.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është rrjedhim i një procesi të zhvilluar në respektim të dispozitave të ligjit procedural dhe atij material dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi.

1. Së pari, gjykata vlerëson të evidentojë kompetencën e saj për shqyrtimin e ankimit objekt i këtij gjykimi në referim të nenit 7 gërma "a", nenit 10 paragrafi 2 gërma "a" dhe nenit 44 të Ligjit nr.49/2012, kjo gjykatë ka kompetencën lëndore dhe funksionale për gjykimin e kësaj çështjeje.

2. Së dyti, vlerëson të marrë në shqyrtim kushtet e pranueshmërisë së ankimeve. Sikurse është referuar edhe më sipër në këtë vendim, rezulton që vendimi të jetë shpallur në datën 03.10.2017. Pala paditëse Ujësjetllës Kanalizme Tiranë sh.a. ka paraqitur ankimi në datën 17.10.2017 (*brenda afatit ligjor*), pra brenda afatit pesëmbëdhjetë ditor nga marrja dijëni, të përcaktuar në nenet 443 paragrafi i parë dhe 444 paragrafi i parë të K.Pr.Civile. Po kështu, nuk rezulton të ekzistojnë kriteret penguese të parashikuara në nenin 45 të ligjit nr.49/2012, që e bëjnë vendimin të paankimueshëm. Ankimi rezulton të jetë i plotë edhe në elementët e tjerë, si në elementët e formës edhe të përmbajtjes, lidhur me nënshkrimin nga pala që e ka paraqitur, tregimin e palëve ndërgjyqëse, vendimin kundër të cilit është paraqitur ankimi, apo kërkimet për të cilat ai është paraqitur. Për të gjitha sa më sipër gjykata çmon se ankimi i paraqitur kundër vendimit nr.3706, datë 03.10.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, objekt gjykimi, duhet të pranohet për shqyrtim.

3. Së treti, në shqyrtimin e ligjshmërisë së veprimtarisë administrative të palës së paditur në raport me pretendimet e ngritura në ankim, Gjykata Administrative e Apelit i referohet parimit procedural të gjykimit administrativ të sanksionuar në neni 37, pika 1 të ligjit nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" i ndryshuar, parim sipas të cilit gjykata shqyrton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet, në bazë të provave të paraqitura nga palët dhe të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ. Për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në gjykim Gjykata Administrative e Apelit gjithashtu i referohet parimit procedural të gjykimit administrativ të sanksionuar në nenin 17, pika 2 të ligjit nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" i ndryshuar, zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme. Ajo i bën një cilësim të

saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët.

4. Gjykata Administrative e Apelit, në analizë të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të ankimit, të provave dhe fakteve objekt gjykimi, vlerëson se pretendimet e paraqitura në ankim dhe ato të paraqitura në kërkesë padi, gjenden të pa mbështetur në prova dhe në ligj, ashtu si me të drejtë ka çmuar dhe Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. **Kjo gjykatë konstaton se gjithë pretendimeve të paraqitura në ankim u është dhënë zgjidhje me vendim nga gjykata e shkallës së parë. Ky vendim rezulton të jetë rrjedhojë e një analize të hollësishme të rrethanave të faktit e të ligjit që janë përcaktuar në mënyrë të plotë e të drejtë. Kjo analizë rezulton të jetë plotësisht e bazuar në kriteret e dispozitave përkatëse të përmendura në vendim, lidhur me vlerësimin nga ana e gjykatës së shkallës së parë të akteve administrative objekt gjykimi, si akte të nxjerra në mbështetje të plotë me ligjin.**

5. Kolegji Administrativ i Apelit, në analizë të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të ankimit, të provave dhe fakteve objekt gjykimi çmon të drejtë qëndrimin e mbajtur nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe vlerëson se, janë të pa bazuar në ligj dhe në prova kërkimet e paditësit për shfuqizimin e Vendimit nr.197, datë 29.12.2016 te Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi të kryer përkundrejt paditësit, **pasi vendimi, nuk ka asnjë element që cenon ligjshmërinë duke shkaktuar pavlefshmërinë relative, pasi është marrë në përputhje të plotë me parashikimet e KMD.**

Në analizë të ankimit e të provave të paraqitura në dosjen objekt gjykimi rezulton se, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr.10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" (KMD), ka shqyrtuar çështjen, duke ndermarrë hapat si me poshte, në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32, pika 2 dhe 33, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi".

Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", parashikohet: *"Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim".*

Me ane të shkresës me nr.25/1 Prot., datë 18.01.2016, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar informacion nga ana e UKT-së, lidhur me ankesën bërë nga [REDAKTUAR]. Duke qene se në përgjigje të shkresës së sipërcituar, pala paditëse UKT, nuk vendosi në dispozicion asnjë informacion, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me ane të shkresës nr.5/2 prot., datë 23.02.2016, ka kërkuar serish informacion UKT-së lidhur me ankesën e Artur Hotit.

Me shkresën nr 5500 prot., datë 09.03.2016, Drejtoria e Përgjithshme e UKT- se, rezulton se ka informuar Komisionerin lidhur me pretendimet e ngritura nga ankuesi, [REDAKTUAR].

Mbështetur në Urdhërin nr.54, datë 30.03.2016, rezulton se inspektorët e KMD-së, kanë inspektuar UKT-në, me datë 04.04.2016, për të administruar informacionin e kërkuar, për

shqyrtimin e metejshem te ankeses se [REDACTED] Gjatë inspektimit, rezulton se ne dispozicion te KMD-së, nuk është vendosur asnjë informacion apo prove, lidhur me kërkesat e urdhërit te inspektimit.

Mbështetur ne nenin 33, pika 8, te ligjit nr.10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e metejshem te çështjes, rezulton se Komisioneri vendosi te realizoje një seancë degjimore mes palëve. Me shkresën nr.25/4 prot., datë 07.04.2016, është bërë njoftimi i palëve për realizimin e seances degjimore. Me datë 11.04.2016, sipas njoftimeve te realizuara, ne seancë degjimore, është paraqitur vetem përfaqësuesi ligjor i ankuesit, [REDACTED] Pavarësisht mungesës se palës ndaj se ciles u paraqit ankesa, seanca degjimore, rezulton se është zhvilluar vetem ne praninë e palës ankuese.

Me datë 12.04.2016, UKT, me ane te shkresës nr.7132/1 prot., datë 11.04.2016 ne përgjigje te kërkesave te Urdhërit nr.54, datë 30.03.2016 te Komisionerit, rezulton se ka vendosur ne dispozicion aktet siç janë cituar ne vendimin objekt gjykimi.

Duke qene se përgjigja e UKT-së, nuk ka qenë e plotë, bazuar ne kërkesat e shkresave te nisura nga KMD, mbështetur ne Urdhërin nr.115, datë 07.07.2016 inspektoret e KMD-së, janë paraqitur serish pranë zyrave te UKT- se, me datë 08.07.2016, për te administruar informacionin e kërkuar, për shqyrtimin e metejshem te ankeses se ankuesit [REDACTED]

Sipas informacionit te administruar gjatë procesit te hetim-inspektimit dhe provave bashkëngjitur shkresës nr.16678/1 prot., datë 17.08.2016 te UKT-së, rezulton se është evidentuar se nga pala e paditur, se për periudhen Tetor 2015-Janar 2016, ne pozicionin Drejtues te Mjeteve, ne Drejtorinë e Transportit dhe Ofiçines, nga pala paditëse, ishin emëruar 7 (shtatë) punonjës te rinj. Në përfundim, nisur nga shqyrtimi i këtyre fakteve, Komisioneri ka gjykuar se: "*Paligjshmëria e veprimeve te ndermarra nga ana e Strukturave të UKT- së, në dëm te ankuesit, kanë sjellë për pasojë edhe vendosjen e tij në kushte të disfavorshme, duke e larguar nga puna pa shkaqe të arsyeshme dhe duke e trajtuar në mënyrë të diferencuar nga pjesa tjetër e punonjësve.*"

Rezulton se, Komisioneri, ka krijuar bindjen se veprimet e ndërmarra nga ana e strukturave te UKT-së, për largimin nga puna të ankuesit [REDACTED] janë bërë ne mënyrë te qellimshme dhe tendencioze, me synimin përfundimtar te largimit te ankuesit nga puna dhe zëvendësimin e tij me punonjës te tjerë.

Në përfundim të shqyrtimit te realizuar, me vendimin nr.197, datë 29.12.2016 pala e paditur, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka vendosur: "*1.Konstatimin e diskriminimit, për shkak te bindjeve politike, të z. [REDACTED] nga ana e Drejtorit te Përgjithshem te Shoqërisë UKT sh.a. 2.Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, te merren masa te menjëherëshme nga ana e Drejtorit te Përgjithshem të Shoqërisë UKT sh.a, për rikthimin ne punë te z. [REDACTED] 3.Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Drejtori i Përgjithshem i Shoqërisë UKT sh.a, të njoftoje Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi. 4.Ne referim të nenit 33, pika 11, te ligjit nr.10221, datë 04.02.2011, 'Për mbrojtjen nga diskriminimi', moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasoje ndeshkimin me gjobë, sipas parashikimeve te pikës 13, te po këtij neni. 5.Kunder këtij vendimi lejohet ankim ne gjykatë, brenda afateve ligjore*".

Rezulton se ne objekt te kerkimit te saj padia ka kundërshtimin në rrugë gjyqësore te aktit administrativ vendimit nr.197, datë 29.12.2016 të marrë nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi për të kundërshtuar vlefshmërinë ligjore te te cilit nuk ka paraqitur asnjë prove apo dispozite konkrete qe te jetë shkelur nga ana e organit qe ka shqyrtuar kundërvajtjen administrative te konstatuar prej palës se paditur.

Ky kolegji çmon të drejtë qendrimin e mbajtur nga gjykata e shkallës së parë dhe vlerëson se, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është nje institucion juridik publik, qe funksionon ne bazë te ligjit nr.10221 datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

Mbështetur ne nenin 21 dhe 32, pika a) e këtij ligji, parashikohet se: "Komisioneri siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo forme sjellje qe nxit diskriminimin".

Nga ana tjetër, Komisioneri ka kompetence:

a) të shqyrtojë ankesat për personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj;

b) të shqyrtojë ankesat nga organizatat qe kanë nje interes te ligjshem për te vepruar ne emër dhe me pelqimin me shkrim te individeve ose grupeve te individeve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi;

c) të kryejë hetime administrative pas marrjes se informacionit te besueshem për shkelje te këtij ligji;

ç) të vendose sanksione administrative sipas përcaktimit te këtij ligji".

Rezulton e provuar se sanksioni përketes administrativ kundrejt palës paditëse është vendosur pas moszbatimit nga ana e palës paditëse te Vendimit nr. 54, datë 28.04.2015 te Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Bazuar ne nenin 33 te ligjit nr.10221 datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", kushdo qe pretendon diskriminim mund te paraqesë ankesa para Komisionerit.

Ne referim te parashikimeve te ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative", (Kodi i cili ka qenë ne fuqi ne momentin e fillimit te procedimit administrativ, pra paraqitjes se ankesës (ankesa është regjistruar me nr.2, datë 08.01.2016), rastet e pavlefshmerise absolute te aktit administrativ parashikohen nga neni 116 te tij, ku sanksionohet se: "Aktet administrative do te quhen absolutisht te pavlefshme, ne kuptimin e këtij Kodi, ne rastet e meposhtme:

a. kur akti është nxjerrë nga nje organ administrativ i pidentifikuar;

b. kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ ne kapërcim te kompetencave te tij ligjore;

c. kur akti është nxjerrë ne kundërshtim me formen dhe proceduren e kërkuar nga ligji. "

Ne referim te parashikimeve te nenit 116 te K.Pr.Administrative, Ky kolegji çmon të drejtë qendrimin e mbajtur nga Gjykata e shkallës së parë dhe vlerëson se, nuk ndodhemi ne kushtet e germes "a" të nenit 116 te K.Pr.Administrative, pasi Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk është një organ i pidentifikuar.

Komisioneri është nje institucion i cili është krijuar dhe funksionon ne bazë te parashikimeve te ligjit nr.10221 datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

Për rrjedhoje nuk ndodhemi ne kushtet e germës "b" te nenit 116 te K.Pr.Administrative, pasi akti është nxjerrë plotësisht ne përputhje me kompetencat qe ligji nr.10221 datë 04.02.2010 i ka

dhenë Komisionerit. Ne bazë të nenit 32, germa “a”, të këtij ligji, parashikohet se, Komisioneri ka kompetence të shqyrtoje ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar.

Po kështu nuk ndodhemi në kushtet e gërmes “c”, të nenit 116 të K.Pr.Adm, pasi akti është nxjerrë në përputhje me procedurën e parashikuar nga neni 33 i ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Në referim të parashikimeve të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, pavlefshëmria relative parashikohet nga neni 118 i Kodit.

Në analizë të sa më sipër, ky kolegji arrin në të njëjtat konkluzione me ato të arritura nga shkalla e parë dhe vlerëson se, Vendimi nr.197, datë 29.12.2016 i KMD, nuk ka asnjë element që çënon ligjshmërinë duke shkaktuar pavlefshmërinë relative, pasi është marrë në përputhje të plotë me parashikimet e LMD, ashtu siç edhe është pasqyruar me sipër. Vendimi i KMD, nuk është në kundërshtim me përmbajtjen dhe qëllimin e ligjit (LMD-së) dhe nuk është nxjerrë nën ndikimin e lajthimit, mashtrimit, kanosjes apo dhunës fizike, elemente këto që do të shkaktonin pavlefshmërinë relative të këtij vendimi.

Për të gjitha sa u thanë më lart, rezulton e provuar në rrugë gjyqësore se Vendimi nr.197, datë 19.12.2016 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është një akt administrativ i drejtë, i bazuar në ligj dhe i nxjerrë në respektim të kërkesave ligjore.

Për sa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se, ankimi dhe padia e paraqitur nga pala paditëse është e pabazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet rrëzuar, qëndrim i mbajtur me të drejtë dhe nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, lidhur me padinë.

6.Kolegji Administrativ i Apelit, në analizë të dosjes objekt gjykimi, të provave dhe fakteve të cilat ndodhen në të, vlerëson se, pretendimet e palës paditëse Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a, në ankim, të cilat janë një përsëritje e kërtimeve të parashtruar në shkallë të parë, dhe nuk ka asnjë provë bindëse që të krijojë bindjen e të determinojë në ndryshimin e vendimit, nuk qendrojnë. Ky kolegji, në analizë të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të ankimit, të provave dhe fakteve objekt gjykimi, **ka vlerësuar të drejtë qëndrimin e mbajtur nga gjykata e shkallës së parë, e cila në zgjidhjen e marrëdhënies objekt gjykimi ka marrë në analizë sejcilin prej shkaqeve të pretenduara nga ankuesi dhe të gjetur në shkelje të ligjit nga KMD.**

Në çështjen objekt gjykimi, rezulton qartë që nga tërësia e provave shkresore si dhe nga analiza që i bëhet Ligjit nr.10221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” dhe Ligjit nr.49/2012 “Për Gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, rezulton se të gjitha veprimet e palës së paditur janë të mbështetura në ligjet e sipërcituar. **Nga analiza e dosjes objekt gjykimi, ky kolegji vlerëson se, pala kërkuese në referim të nenit 35 të ligjit nr.49/2012, nuk arriti të paraqesi prova që të provojë ligjshmërinë e kërtimeve si dhe faktet që ka parashtruar dhe ka vënë në themel të veprimtarisë së kundërshtuar në gjykatë nga pala kërkuese, kërkim i cili është rrëzuar nga Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.**

7.Gjykata Administrative e Apelit, në analizë të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të ankimit, të provave dhe fakteve objekt gjykimi, vlerëson se, bindjet politike të punëmarrësit janë një e drejtë e tij, e lirë për t'u ushtruar sa kohë nuk ndikojnë në rregullsinë e përmbushjes së detyrimeve kontraktore në funksion të punës së ushtruar.

8.Kolegji Administrative i Apelit, çmon se procedura e zhvillimit të këtij gjykimi rezulton të jetë në përputhje të plotë me dispozitat e Kodit të Proçedurës Civile dhe të ligjit nr.49/2012. Nuk konstatohen shkelje si në procedurën e zhvillimit të gjykimit edhe në procedurën e marrjes së vendimit nga gjykata e shkallës së parë.

9.Gjykata Administrative e Apelit, në analizë të ankimit të paraqitur nga pala paditëse, ndaj vendimit nr.3706, datë 03.10.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e në analizë të akteve të dosjes si dhe në referim të përcaktimeve të ligjit material dhe proçedural që gjen zbatim në rastin konkret, çmon se: Vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është rrjedhim i një procesi të zhvilluar në respektim të dispozitave të ligjit proçedural dhe atij material dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi.

10.Për të gjitha sa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson tërësisht të pabazuara në ligj e prova pretendimet e parashtruara në ankim, e si të tilla duhen rrëzuar, pasi vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është marrë në analizë të plotë të rrethanave të faktit e të ligjit. Referuar nenit 50 gërma "b" të ligjit nr.49/2012, kjo Gjykatë vlerëson se ky vendim duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj çështjeje, gjykata mbështetur në nenin 50 gërma "b" të ligjit nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative",

VENDOSI

Lënien në fuqi të vendimit nr.3706, datë 03.10.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë brenda 30 ditëve duke filluar nga e nesërmja e komunikimit të këtij vendimi.

U shpall në Tiranë, sot më datë 12.12.2019.

ANËTARE
Altina NASUFI
d.v

ANËTARE
Fjoralba PRIFTI
d.v

KRYESUES
Arjan Qafa
d.v

Vertetohet njesia me origjinalin

Kancelar
Leonard Strataj



